

LIGJ
Nr.9706, datë 5.4.2007

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8685, DATË 9.11.2000 "PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË
PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në fund të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Pagesa e trajtimit të veçantë ndërpritet për aq kohë sa personi përfiton të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar, me përjashtim të personave, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi e blegtori."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5267, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu
